



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-064

Prishtinë, më 21 maj 2012, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 21 MAJ 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Bilall Sherifi, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Sherif Konjufca;

Nga Zyra e Presidentes: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 7 maj 2012.
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 7 maj 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 7 maj 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi të mbajë mbledhje plenare më 24 maj 2012, me këtë

R e n d d i t e:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e këmbimit të Notave Diplomatieke për statusin e forcave të huaja mes Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Teatrot,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore,

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbeturina,
13. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2011,
14. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2011,
15. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2011,
16. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2011,
17. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, për vitin 2011,
18. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2011,
19. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2011,
20. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2011,
21. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me “Listën për Rentat Minerare”,
22. Shqyrtimi i Propozimit të Institutit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
23. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave:

3.1 Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e këmbimit të Notave Diplomatike për statusin e forcave të huaja ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e projektligjit të cekur më lart, vendosi që atë ta radhisë në rend dite për shqyrtim në mbledhjen plenare, më 24 maj 2012.

3.2 Rekomandimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbajtjen e një seance të veçantë për 1 Qershorin - Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e cekur më lart, vendosi që Kuvendi të mbajë seancë të veçantë më 1 qershor 2012, për ta shënuar Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve.

3.3 Vendimi i Presidentes lidhur me kthimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës në rishqyrtim

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me vendimin e Presidentes, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi që ta shqyrtojë vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës lidhur me kthimin e nenit 37 dhe 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës për rishqyrtim dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

3.4 Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve të Bordit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Propozim-vendimin e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, që ta shqyrtojë propozim-vendimin e Komisionit për Përzgjedhjen e Anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

3.5 Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për vizitën e Delegacionit të Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Madh të Turqisë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për 8 (tetë) anëtarë të delegacionit të Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Madh të Turqisë, që do ta vizitojë Republikën e Kosovës, prej datës 28 deri më 30 maj 2012.
2. Të gjitha shpenzimet e akomodimit, të transportit lokal dhe dy drekave të shtruara nga nënkryetari i Kuvendit, Enis Kervan, dhe kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme, Albin Kurti, për delegacionin e lartpërmendur në paragrafin 1 (një) të këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3.6 Ftesa e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Drejtësisë, Hajdin Kuçi

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e zëvendëskryeministrit, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i deputetëve të Kuvendit: Lutfi Haziri, Ahmet Isufi dhe Arben Gashi, për të marrë pjesë në takimin e parë inaugurues të Dialogut të Strukturuar për Sundimin e Ligjit, që do të mbahet në Bruksel, prej 29 deri më 31 maj 2012.
2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

3.7 Ftesa për lejimin e vizitës në Komisionin për Çështje Politike dhe Demokraci të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës

Kryesia, pasi e shqyrtoi ftesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i deputetëve të Kuvendit të Republikës, në këtë përbërje: Hydajet Hyseni, Vjosa Osmani dhe Jasmina Zhivković, për të marrë pjesë në takimin e radhës të Komisionit për Çështje Politike dhe Demokraci të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, në Paris, prej 29 deri më 30 maj 2012.
2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

3.8 Njoftimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me Raportin vjetor të Performansës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2011

Kryesia u njoftua me propozimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për ta shtyrë shtypjen e Raportit vjetor të performansës së ZAP-it dhe publikimin e tij në faqen zyrtare, derisa auditorët e jashtëm ta kenë dhënë opinionin dhe rekomandimet e tyre. Raporti të procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare, pasi të jetë i shtypur në libër, me pasqyrat financiare.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 15:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale